



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:284038

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654820

KF.nr.95/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me procesmbajtësen Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar administrativ të paditësi “Mili Company” SH.P.K., me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SCLR Partners – Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje sipas Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 926/23 të datës 12.02.2024, të dhomave të shkallës së dytë të kësaj gjykate, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 29.04.2024, të mbajtur në mungesë të palës paditëse dhe në prani të përfaqësueses së autorizuar Blerta Gagica, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Mili Company” SH.P.K. me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi Nr.01.3.2.2/6712, 7686, 8362 i datës 11.07.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Dhomat e shkallës së dytë me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 926/23 të datës 12.02.2024, e kanë aprovuar si të bazuar ankesën e këtu paditësit, e kanë anuluar Aktgjykimin A.nr. 1959/19 të datës 08.06.2021 dhe lëndën e kanë kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit Nr.01.3.2.2/6712, 7686,

8362 i datës 11.07.2019 për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, shkeljes së dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka prezantuar askush për paditësin, edhe pse i njëjti ftesën për këtë seancë e ka pranuar me datën 25.03.2024, e cila vërtetohet nga fletë-kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa mungesën – mospjesëmarrjen nuk e ka arsyetuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi aktvendimin kontestues si të ligjshëm. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës deklaroi: vlen të theksohet se paditësi nuk ka deklaruar transferet bankare në bazë të të cilit do të dëshmoj pagesat për mallin lëndor. Andaj mbesim në tërësi pranë vendimit të nxjerrë nga Dogana. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 01.3.2.2/6712, 7686, 8362 i datës 11.07.2019, përgjigja në padi e datës 25.09.2020, ankesa e ushtruar në Doganë, DUD-at 5213, 5582, 4871, 4712, 6751, 6545, 5833, 4595, 2271, 2819, 6952, 7221, 7655, 8321, 8622, 7220, 9941, 1087, faturat nr.478, 473, 471, 2019-04, 2019-05, 475, 474, 470, 2019-02, 2019-3, 477, 482, 479, 480, 481, 482, 2019-06, 2019-07, 2019-08, deklaratat EX A, proceset mbi përcaktimet e vlerës së mallrave, urdhërpagesat dhe pagesat e detyrimeve doganore, vëzhgimet e urdhër transfereve bankare ndërkombëtare të datës 05.08.2020, 02.06.2020, 24.01.2020, 13.08.2020, 26.11.2020, CMR, kontratat e shitjes së datës 25.07.2016, 14.07.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe

arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në ankesë/padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti “Mili Company” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka paraqitur DUD-at R5213/15.05.2019, R5582/22.05.2019, R4871/08.05.2019, R4712/04.05.2019, R6751/15.06.2019, R6545/11.06.2019, R5833/28.05.2019, R6952/19.06.2019, R7221/25.06.2019, R7220/25.06.2019 proceduar të ZBD Prishtina 3, për zhdoganim malli lëndor sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë (6) të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109, respektivisht në bazë dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës.

Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesa në Doganën e Kosovës, e për të cilat ankesa e paditura ka sjell aktvendimin Nr.01.3.2.2/6712, 7686, 8362 me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ave të lartcekur, duke lënë në fuqi të njëjtit, e ndaj të cilin aktvendim paditësi “Mili Company”, me padinë ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “Mili Company” me seli në Prishtinë, këtu paditësit, për rishqyrtimin e DUD-ave R5213/15.05.2019, R5582/22.05.2019, R4871/08.05.2019, R4712/04.05.2019, R6751/15.06.2019, R6545/11.06.2019, R5833/28.05.2019, R6952/19.06.2019, R7221/25.06.2019, R7220/25.06.2019 të ZBD Prishtina 3. Me arsyetim se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallin lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së.

Tutje, ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit është bazuar në metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit neni 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave

të disponueshme të Doganës së Kosovës, zhdoganimeve të mëhershme të mallit të ngjashëm që pasqyron vlerën reale për këtë lloj të mallit si dhe dosjes së vlerave, andaj, edhe në rastin konkret është vepruar drejtë kur si vlerë referencë është marrë çmimi i mallit nga dosja e vlerave, si dhe të dhënat nga zhdoganimet e mëhershme të mallit të ngjashëm.

Po ashtu, ka theksuar nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, pasi që subjekti në procedurë për asnjë Deklarate Unike Doganore nuk ka bashkangjitur deklaratat eksportuese të shtetit eksportues dhe transferet bankare. Pra, në rastin konkret nuk kemi dokumentacion të mjaftueshëm në kuptim të forcimit të bindjes së Doganës lidhur me vlerën reale të mallit, ndërsa në anën tjetër duke pasur parasysh edhe faktin që Dogana e Kosovës disponon me të dhëna se vlera e mallit lëndor është vlerë më e lartë se sa vlera e deklaruar nga subjekti ankimor.

Gjithashtu e paditura ka theksuar se sa i përket pretendimit të subjektit se me rastin e deklarimit për doganim të këtij malli, importuesi edhe përkundër ofrimit e posedimit të gjitha dëshmive dhe dokumenteve të nevojshme nuk janë marrë parasysh, Dogana e Kosovës konstaton se janë të pa qëndrueshme, pasi që subjekti nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, pasi që në shkresat e lëndës mungojnë deklaratat eksportuese të shtetit eksportues dhe transferet bankare, e po ashtu bazuar në vlerën e tregut të këtij lloji të mallit subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale, pasi që ka deklaruar vlerën e mallit dukshëm më të ulët se vlera reale e këtij lloji të mallit. Prandaj, në këtë kuptim Dogana e Kosovës konstaton se në rastin konkret nuk mund të veprohet sipas kërkesës së subjektit ankimor, andaj Dogana ka bërë vlerësimin e provave konform nenit 89 të LPA-së dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Pra, Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 dhe nenit 34 par.2 pika a), b), c) të KDA-së, duke sjellë aktvendimin e kontestuar në pajtim me nenin 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen

faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se me rastin e deklarimit të mallit kemi poseduar dhe prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat janë të parapara për shoqërimin e mallrave të destinuara për import të cilat përcaktohen me KDAK-së dhe UA nr.11/2009, kjo për faktin se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar, përkatësisht i njëjti ka prezantuar faturat e mallit por jo edhe transaksione bankare ndërkombëtare të harmonizuara në kuptim të përshkrimit – referencës me faturë kontestuese dhe shumës sikurëse në faturat kontestuese, për të dëshmuar pagesën e faturave për DUD-at R5213/15.05.2019, R5582/22.05.2019, R4871/08.05.2019, R4712/04.05.2019, R6751/15.06.2019, R6545/11.06.2019, R5833/28.05.2019, R6952/19.06.2019, R7221/25.06.2019, R7220/25.06.2019.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Pala paditëse nuk ka prezantuar ransaksione bankare ndërkombëtare të harmonizuara për të vërtetuar vlerën e transaksionit sipas faturave dhe çmimit blerës të mallit. Prandaj, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor për Deklaratat Unike Doganore R5213/15.05.2019, R5582/22.05.2019, R4871/08.05.2019, R4712/04.05.2019, R6751/15.06.2019, R6545/11.06.2019, R5833/28.05.2019, R6952/19.06.2019, R7221/25.06.2019, R7220/25.06.2019 të ZBD Prishtina 3 duke aplikuar metodën gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht të dhënave të disponueshme.

Gjykata vlerëson se e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit me pagesa bankare të harmonizuara të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare, gjë të cilën këtu paditësi nuk e ka bërë, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme.

Në vijim pretendimin e paditësit se e paditura ka bërë shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar, ngase përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtrij faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-së. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109.

Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se ka ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar vlerën e saktë të mallit, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar - administrativ është i pamjaftueshëm në mungesë të transaksioneve bankare ndërkombëtare për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqitur vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”.*

Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezultoi të mos ketë dorëzuar dokumentacionin e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provojë edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, paragraf 1, dhe nenit 46, paragraf 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.94/24 datë 29.04.2024

Procesmbajtëse,  
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.